

ROBERT HAJRO

BIBLIOTEKA

85H-1


H/19

GJURMA JETE

8SH-1  
H 19

ROBERT HAJRO

GIURNAJEE



TURKU LINDJA 2004

# "Gjurma jete" në rrighthjet e zemrës

Kritikë nga  
Prof. Myzafer XHAXHIU

Më ka rënë në dorë libri me vjersha "Gjurma jete" i ish oficerit ing. Robert Hajro. E kam njojur Robertin që fëmijë në Strehën Vorfnore, siç quhej atëherë. Ishin vitet '43-'44 kur unë isha kujdestar në atë shtëpi fëmijësh jetimë, ose nga familje shumë të varfra. Që nga ajo kohë e kam takuar të rritur, burrë rreth të gjashtëdhjetave, tanimë oficer topograf e gjeodet në pension.

Është i dhënë shumë pas leximit të veprave letrare, çka e ka sh-tyrë të hedhë në letër vargje dhe të botojë së bashku me disa skica letrare në prozë, librin me titull "Gjurmë jete". Në të gjitha vjershat e tij, të bie në sy pasioni, dashuria për të vënëtë në dukje virtutet morale, dashurinë për njeriun, gaditshmërinë për t'u ardhur në ndihmë fatkeqëve e të tjera. Vargjet e librit edhe pse nuk dallohen për ndonjë vlerë të vecantë estetike, të lenë mbresë për atë belbëzim të sinqertë e me zemër të hapur për t'i transmetuar lexuesit mendime e ndjenja të bukura, emocione të sinqerta të përf-tuara nga një jetë plot hije e dritë: "Punoni, punoni/ Asnjëherë mos përtoni/ Që veten ta nderoni/ Dhe fisin ta lartësoni." Në këto dhe në vargje të tjera, është e vështirë të gjesh poezinë, por të paktën gjen ndjenjën e ngrohtë e të sigertë për bukurinë e jetës, për dashurinë familjare, për miqtë dhe shokët: "Erdhën miq e shokë/ Ditëlindjen time të më urojnë/ Njerëzit e shtëpisë/ Dhe të gjithë miqtë e mi gëzojnë".

Vjershëtori belbëzon i frymëzuar nga malli dhe dashuria për nënën e ndarë ngajeta:

Kam një vazo në ballkon  
Me trëndafila kuqëron  
Nëna ato fort i donte  
Se ballkoni kundërmonte....

Në strofën e dytë autorri premtion se këto lule do t'i vaditë e do t'i ruajë që t'ia çojë nënës tek varri.

Inxhinieri Topo-gjeodet, që e ka vizituar vendin tejendanë me këmbë, se i tillë ishte profesioni, sjell në vargje ndjenjat e tij të dashurisë ndaj njerëzve të thjeshtë, fshatarëve mikpritës, ngrohtësinë e peisazhit shqiptar.

Në vargjet e këtij libri ka ngjarje, episode, çaste të përjetuara me gëzime e trishtime. "Nga një jetë ~~me~~ të përpjeta" çka përbën atë taban realist, zëri i të cilit troket në jetën e cilitdo që e quan veten njeri.

Në të gjitha vjershat bie në sy prurja përfshirë temat, motive me përbajtje sociale e morale, të flladitura me notën e optimizmit: "Kur ke dëshirë të shkruash poezi/ Fut në to vargje me djersë/ Fut në to dhe dashuri/ Fut në to vargje me shpresë". (Motiv).

Po në këtë vjershë autorri thotë: "Shumë njerëz shkruajnë poezi/ Frymëzohen nga arritjet/ Dhe nga ndryshimet në vitet". Në vargje të tillë ndjen rrahjen e zemrës së qytetarit që e do vendin e vet ashtu siç është.

Po në vjershën "Motiv" thotë se "nuk mund të rrish pa shkruar kur e sheh jetën në sy"- shkruan autorri një vjershë të librit "Gjurmë jete". Libra të tillë me vjershërim hyjnë në foqdin e krijimtarisë popullore dhe së bashku me krijimtarinë kulte të fjalës artistike përbëjnë historinë e letërsisë kombëtare. Kjo është një dukuri komplekse edhe si e tillë duhet studiuar.

TIRANA NË SHEKULLIN E XXI

---

*Tirana kryeqytet i Shqipërisë,  
Qyteti madh e i bukurisë,  
Qytet i ëndërrave të lirisë,  
Je kërthiza e Shqipërisë.*

*Linde në një fushë nga hiçi,  
E rrite shtatin me shtëpi qerpiçi,  
Pastaj me pallate aq sa arriti vinçi  
Tek, tuk shikon shtëpi muze qerpiçi.*

*Në fillim të viteve nëntëdhjetë,  
Tirana filloi të shpërfytyrohet,  
Me fryme filloi të mos ngopet,  
Nga kioskat e shumta e shkatërrimet.*

*Në qëndër ku kishte sheshë,  
Aty u bë persheshë!  
Na u bënë kioskat peshqeshë,  
Tirana humbi emrin perëndeshë.*

*Por edhe parkut “Rinia”  
I humbi stolia,  
Nuk shikoje gjelbërira,  
Nga kioskat pa hapsira.*

*Në vendin te lumi Lana  
U ngritën shtëpi të gjana,  
Sa nuk kishte hapsira,  
Ku të pasqyrohesh hana.*

*Kudo kishte rrugë me gropat,  
Sikur ishin rrahur me topa,  
Makinat në çdo metër jepnin sinjal në stopa,  
Prindërit detyrohen të mbanin fëmijet hopa.*

*Dhe ja erdhi radha të shemben,  
Te parku “Rinia”kioskat te pastrohen,  
Me stola te bukur e bar po shtohen,  
Të gjithë njerëzit filluan të gëzohen.*

*Jo shume vonë i erdhi radha Lanës,  
Ju përgjigjën 18 firma Edi Ramës,  
Për 45 ditë s’mbeti asnje kioskë anës,  
Tani s’kishte kush t’ia zente dritën Hanës.*

## GJURMË JETE

---

*Sa bukur duket sot ky kryeqytet,  
Çdo gjë u kthye në identitet,  
Kjo gjë është e vërtetë,  
Për tu bindur, hajdeni dhe shikojeni vetë.*

*U ngritën pallate me shumë kate,  
U zgjeruan lulishte e bulevardë,  
U zbuluan rrugë e universitete,  
Dhe jo pak vila me verande.*

*Çdo ditë e më e bukur do bëhet Tirana,  
Me pallate të bukura e rrugë të gjana,  
Ndërtimet pa leje po prishen të tana,  
Në këto arritje ka merite edhe Edi Rama.*

*E bukur e madhe është Tirana,  
Kudo pallate e sheshe të gjana,  
Rrugët me neon, me dritë si hana,  
E mes për mes kalon e bukur Lana.*



## *GËRMADHË*

---

*Ishte lufta e dytë botërore,  
Aerooplanët zhurmonin përmbi re,  
Bombat që ranë bën shumë krimë,  
Ndër to ishte dhe shtëpia ime.*

*Tre bomba na ranë mbi shtëpi,  
E ajo u bë shkrumb e hi,  
Çdo gjë atje u nxi,  
E asgjë në këmbë nuk mbeti.*

*Të parët tanë atje kishin jetuar,  
Me mund dhe djers e kishin ndërtuar,  
Prandaj kurrë nuk duhen harruar,  
Që planet për luftë duhen shkatërruar.*



*REFUGJATT*

---

*O mjera Shqipëri e mjera ti,  
Si nuk mundesh me mbajtë fëmijët në gji?  
Ka q e varfër qenke ti?  
Sa të marrin rrugët në arrati?*

*Djemtë po marrin malet, natën e me shi,  
Në vende të largëta le të bëjë stuhi,  
Duke lënë mbrapa gruan me fëmi,  
Tokat ndjerë, shtëpi, bagëti e katandi.*

*Herë me pune e herë pa punë,  
E kur ka gjetur punë, edhe e kanë përzënë,  
Duhet durim se ndryshe nuk fiton paranë,  
Kjo nuk arrihet pa bredhur gjithë dynjanë.*

*Refugjati është gati çdo punë të bëjë,  
Megjithëse nuk është lehtë ti bësh kollaj,  
Por është i detyruar se është në dhe të huaj,  
Shume djers derdh, ndryshe s'ka si të bëj.*

*E rëndë ështëjeta e refugjatit,  
Por halli të bën të bësh jetën e qiellit,  
Dhe fati është në dorë të zotit,  
Çdo lekë që fiton e ka me djersë të ballit.*



## GJURMË JETE

---

### *ISH SKËNDERBEGASVË*

---

*Skënderbegas u quajtën qysh 11 vjec.  
Një emër i bukur, një emër nder  
Kështu quhem i edhe 70 vjec,  
Kështu i thërrasim shoku kushedi sa herë.*

*Të vegjël ishim, por shpejt u burrëruam,  
Në stërvitjë të rënda shpejt u mësuam,  
Për dije të larta kudo vrapuam,  
Mësuam: Atdheun, prindërit, shokun ta duam.*

*Ecim me këngë, me hap djalërie,  
Kënga plot zjarr, e hapi kishte hije,  
Por edhe sportin nuk mund t'a lije,  
Sepse ishin pjesë e kësaj ushtrie.*

*Vitet e shkollës nuk mund t'i lemë pa kujtuar,  
Me shokët takohemi me mall të pashuar;  
Krenohemi për punën e pashtuar;  
Që bëjnë Skënderbegasit me zjarr në kraharuar.*

*Robert Hajro*

---

*I gjen ata në çdo qoshe të Atdheut,  
Oficer, pilot, këmbesor, e marinar;  
Sportist, artist, shkrimtar e gjeneral  
Që mbajnë lart shpirtin atdhetar.*

*Ish Skëndërbegas*

*Robert Hajro*

*Tirane, 28.03.2004*



VENDLINDJES

---

*Çdo njeri ka një vendlindje  
Pyetja që të bëjnë është: Nga je?  
Ai emër të gjithëve u ka hije,  
Është një vend me plot dije.*

*Vendi i lindjes është Gjirokastra,  
Mbi nivelin e detit është mbi 200metra,  
Bijt e saj të kujtojnë përhera,  
Për të kanë shkruar me dhjetra .*

*Kur e sheh ditën, sheh çati gri,  
Të gjithe çatitë janë një mbi një,  
Natën sheh shumë drita në shpatmali,  
Çdo dritë nga ato përfaqëson një shtëpi.*

*Në atë qytet kanë lindur shumë atdhetar,  
Njerëz të fortë, trima e kordhëtarë,  
Të besës, të punës e mendimtar,  
E kanë patur për nder të quhen Shqipëtar.*

*Ky qytet si libër me shumë flet,  
Do të hapet nga brezat që vijnë,  
Do mbetet si vend i shenjtë,  
Një emër i bukur që kohërat s'ë fshijnë.*



## GJURMË JETE

---

### ATDHEUT

---

*Një atdhe ka çdo njeri,  
Atdheu ynë quhet Shqipëri,  
Kur je larg tij, malli të djeg në gjë,  
Në gjirin tënd çdo njeri don të rri.*

*Çdo gurë rëndon në vend të vet,  
E çdo zog do folenë e vet,  
Dashuria për atdheun nuk zhdukjet,  
E ajo qëndron e gjallë në jetë.*

*Një nënë na ka bërë,  
Por një vend kemi të tërë,  
Emri i jot është me vlerë,  
Të duam si shumë të tjerë.*

*Kur vjen puna për Atdhe,  
E rrezikun ndaj tij ndjejmë,  
Roje rrjmë në kështjellën me beden,  
Armikun të kaloj nuk e lemë.*

*Puno e lufto për Atdhenë,  
Sepse aty kemi folenë,  
Këtë tokë ta lulëzojme,  
Dhe të jemi gati ta mbrojmë.*

*Atdheu dhe nëna nuk harrohen,  
Njerëzit i kujtojnë sa herë largohen,  
Të gjithë me to krenohen,  
Në emër të tyre përgjërohen.*



## GJURMË JETE

---

### LËTËR

---

*Sot u ktheva nga rruga e gjatë,  
Shtrëngoj penën me dorën time,  
Vallë si kalon hallet gruaja ime?  
Përplas... mbi letër dhjetra mendime.*

*Sot grua po të shkruaj këtë letër,  
Largësia nga ju mi njalli mendimet,  
Më afër se ju s'kam tjetër,  
I puth nga larg të dy fëmijët.*

*E rëndë ështëjeta larg shtëpisë,  
Larg të afërmve e larg shoqërisë,  
Jemi topografët e parë të ushtrisë,  
Që t'i japim harta Shqipërisë.*

1966, Shtator 1966

*LUFTHA*

---

*Në botë janë bërë shumë luftra,  
Në to janë mpleksur shtete të tëra,  
Popujt nga ato mbetën fukara,  
Të gjithë thonë se s'janë të mira.*

*Nga lufta e padrejtë asnje s'fiton,  
Nga të dyja palët gjaku buron,  
Edhe bilbili këngën pushon,  
Çdo nanë për djalin e vrarë vajton.*

*Kur vjen puna për luftë të drejtë,  
Janë të gjithë në këmbë, kjo nuk është sekret,  
Armikun asnijëherë mos ta lemë të qetë,  
Edhe këmbët ti dridhen sikur bie tërmët.*

*Edhe populli yne luftoi,  
Në luftën e dytë dhe fitoi,  
Armiku ashtu si erdhi dhe shkoi,  
Për liri, populli shumë bijë fljoi.*

## GJURMË JETE

---

*Kurrë të mos bëhet luftë e tretë,  
Se ajo do ketë jo topa por raketë,  
Dhe do lejë çdo vend të shkretë,  
Këtë se parashikon asnjë profet.*

*Çdo luftë mund të shmanget,  
Kur për paqe bashkohen kombet,  
Edhe armët atëherë do hidhen në det,  
Më shumë zhvillim do ketë çdo shtet.*



## *VËLLEZËRVE*

---

*Në jetë ka lajme kob të zi,  
Të tilla kam patur kur isha femi,  
Të tilla kam patur në rini,  
por më të rënda i dëgjova në plegëri.*

*Dy vëllezër më ikën të rinj,  
Veçse unë s'mund t'i besoj,  
Shikoj lart e pyetjen drejtoj,  
Dhe me zë filloj e vajtoj.*

*Kujtimet tuaja unë i ruaj përhore ,  
Dhimbja ime është e madhe e nuk shterë,  
Për tu çmallur në varre vij përherë,  
Por edhe të afërrmit e tjerë vijnë u bëjnë ndër.*

*Të dashurit e zemrës nuk vdesin,  
Sepse ato në mendjet tonë mbèsin,  
Çdo punë të mirë tuajën ne njohim,  
Në fotografi dhe video ne ju shohim.*



*ATA TË DY*

---

*Pashë një vashë tek shkonte,  
Nga bukuria asnë s 'ia kalonte,  
Dhe një djalë e përgjonte,  
Mezi priste ta takonte.*

*Në endërr i dilje ti,  
Për ty thurri një poezi,  
Moj vajzë sy shkëndi!  
Ky zjarr më dogji në gji.*

*Të dua i thosh ai,  
Ma thuaj emrin se s 'ta di,  
Moj vashë je peri,  
Të dua e do të mbaj në gji.*

*Mos u nxito por prit,  
Kur të shuhet ylli Afërditë,  
Do të vij të të bëjë dritë  
Natën do ta bëj ditë.*



## FJALÄ E ËMBËL

*Janë ilaç fjalët e ëmbëla,  
Prandaj fol pak por të ëmbëla,  
Kush është gojë ëmbël,  
Han përshesh me t'ambël.*

*Prej goje mos nxirr vrer,  
Por që të ëmbëlsohesh nxirr sheqer,  
Njerëzit e mirë lavdërohen përherë,  
Dhe me përzemërsi i bëhen nder.*

*Fjala e ëmbël thërret miq,  
Ajo zbut, por edhe pajton armiq,  
Prandaj fjalët e hidhura i hiq,  
Si qeni gurët, mos i ndiq.*

*Dy gjilpëra majë më majë s'puqen,  
Me fjalë të ëmbëla inatet ndreqen,  
Fjala e ëmbël, të keqen të heq,  
Atij që flet pa karar, vari teneqen.*



## GJURMË JETE

---

### NË NJË DITË PRILLI

*Dal herët në mëngjes,  
Eci mbi barin me ves,  
Shqerën e butë filloj e pres,  
Këtë dua të bëj deri sa të vdes.*

*Shikoj një lule, një trëndafil,  
Aty afër i rri një bilbil,  
Zgjas dorën e ti marr erë,  
Bilbili më bukur këndoi këtë herë.*

*Kënga e bilbilit dilte nga zemra,  
Në të kishtë fjalë të mençura,  
Se vitet do kalonin të përsosura,  
Të dyja zemrat do bëhen të lumtura.*



## *TOPOGRAFIT*

---

*Aeroplani mbi Shqipëri bëri fluturime,  
Mbuloi vendin me fotografime,  
Pastaj topografët bën deshifrime,  
Përgatitën hartat me ndryshime.*

*Ngarkonim kafshët me materiale,  
Ngrinim çadrat nëpër male,  
Rrugën e bënim me kalë shale,  
Nga vështirësitet s'kishin gajle.*

*Nëpër kodra, fusha e male,  
Ngrenë kudo pika trigonometrike,  
Ecin me nivacion nëpër zalle,  
Pastaj bëjnë llogaritje matematike.*

*Vrejtet qelli ulen retë,  
Piramidën se lejnë me vrejtë,  
Pret sa të shpërndahen rete,  
Pastaj ben matjet e këndeve në rrjetë.*

## GJURMË JETE

---

*Në majë të malit, s'ka njeri,  
Milingonat, zogjt i bëjnë shoqëri,  
Dielli lart ndrin si flori,  
Me teodolit mat këndet një nga një.*

*Pa aguar mirë, dielli pa dalë,  
Nis topografi rrugën për në malë,  
Dielli tutje detit zë largohet,  
Topografi kthehet pas pune e gëzohet.*



## PRINDËRVE

---

*Nanë, është njeriu më i dashur në jetë,  
Nanë, është emri më i bukur në botë,  
Nanë, është lindja dhejeta e vërtetë,  
Nanë, është njeriu më i afërt e i shtrenjtë.*

*Në ditë lufte jetim u gjendem të tre,  
Mes dimrit acar ne mbetëm jashtë nën re,  
Qamë, mbërdhim, por më shumë pamë tmerre,  
Kështu kaluam vitet ne atëhere.*

*Por ne nanën pak e njohëm,  
Ajo vdiq e re pas pak edhe baba,  
Tre bomba ranë në shtëpi e ajo ra,  
Kjo për ne të tre ishte një hata.*

*Kështu të tre vëllezërit mbetëm jetim fare,  
U tretën gjëzimet tonë fëminore,  
Të afërmith na çuan në "Strehën Vorfnore",  
Që për ne ishte një jetë e re.*

## GJURMË JETE

---

*Shpesh për prindërit na merrte malli,  
Por e dinim që ato dergjeshin te stralli,  
U mësuam dalëngadalë me jetën e re,  
U bëmë si një familje në "Strehën Vorfnore".*

*U rritëm nëpër shkolla pa përkëdhelje nëne,  
U rritëm e nuk kishim lekë të blenim panine,  
U rritëm e s'arritëm të shkonim me pushime,  
U rritëm dhe e kuptuam qëjeta ishte e zorshme.*

*Në jetën kolktive ne u rritëm,  
Me vështirësitë e jetës ne u kalitëm,  
Ne shkollat, klasat një nga një i ngjitetëm,  
Objektivat në jetë i arritetëm.*

*Kaluan shumë vite e ne u bëmë burra,  
Por nënë e babë si harruam kurre,  
Te tre vëllezërit u martuam si gjithë të tjerë,  
Por jetën e vështirë e kujtonim përherë.*

*Kështu ështëjeta e do të mësosh,  
Ashtu si të vij e do të durosh,  
Por kryesorja është me ndër të luftosh,  
Që jetën sa më bukur ta jetosh.*



*MËSAVË*

---

*Në shtëpi kam dy mbesa,  
Janë të bukura si lule me ves,  
Janë e ardhmja, janë shpresa,  
Do t'i dua deri sa të vdes.*

*Gjyshja e tyre quhet Vera,  
Për to kujdeset si përhera,  
I jep të hanë pa dalë nga dera,  
I rrit si lulet nëpër sera.*

*Ishin të vogla e tani u rritën,  
Klasat një nga një i ngjitën,  
Objektivat në shollë i arritën,  
Me punë veten e ndritën.*

*Nuk thonë kot :  
Janë mjalt i mjaltit,  
pa to s'rrim dot,  
qofshin të lumtura dhe të fatit.*



## GJURMË JETE

---

### NIPIT

Dhe ja me një nipçe u bëra,  
Ka gjak edhe nga Vlora,  
Kështu na e donte sëra,  
I ka të mira të tëra.

Kur na vjen në shtëpi,  
Të gjithë gëzojmë,  
Nëna i jep diçka me pi,  
Pastaj zemë e fluturojmë.

Vjen i shëndetshëm e rrumbullak,  
Çdo ditë rritet nga pak,  
Të gjithë e kemi merak,  
Dhe përkëdhelet, i ka hak.

Rritu, rritu e bëju burrë,  
Me shëndet e plot nurë.  
Mos lë dije pa marrë,  
Por babë e nanë mos i harro kurrë.



*PRANVERËS*

---

*Mezi pres të kaloj dimri,  
E në shtëpi te oxhaku rri,  
Jashtë gjëmon e bie shi,  
S'vete dot as te një komshi.*

*Dhe ja iku dimri vjen pranvera,  
Zgjohen kafshët dhe gjithë natyra,  
Manushaqja çel nëpër fera,  
Bilbili këngës ja mori si përhera.*

*Erdhi pranvera, kthehen dallendyshet,  
Toka me bar zë e mbushet,  
Dielli zë e lartësohet,  
Dita zgjatet dhe zë e ngrohet.*



## GJURMË JETE

---

### TE BURIMI

---

*Te burimi afér fshatit,  
Uji rrjedh e gurgullon,  
Atje shojnë dy vajza 8 sahatit,  
Ku bilbili bukur këndon.*

*Ngajnë si dy pika uji,  
S'di kë të zgjedhë djali,  
Njëra zemrën ia fali,  
Tjetrën e priste bariu te mali.*

*Te burimi çdo mëngjes,  
Tani vajzën mezi pres,  
Kur ajo vjen, me hyp i kuqi i faqes,  
Zenë e kuvendojmë në fund të baçes.*



### *NË TELEVIZOR*

---

*Ndonëse kam punë,  
Gjej kohë edhe për televizor,  
Në të shikoj larminë,  
Të largohem prej tij është zor.*

*Mendoj sa shumë ka ecurjeta,  
Dikur na dukesh gjë e madhe radio,  
Mblidheshim e dëgjonim radio-posta,  
Ateherë nuk kishte as televizor e as video.*

*Çfarë kanë sot programet?  
Ku ta çoj më parë,  
Te TVSH, TVA, Tele-sport apo Klan.  
Të gjitha programe të bukurë kanë.*



### FAMILJA

---

*Familja është themeli i shoqërisë,  
Ajo është foleja e lumturisë,  
Fëmijët janë lulja e shtëpisë,  
Nëna lufton që ato t'i rrisë.*

*Në familje kalon shumë gëzime,  
Por jeta ka edhe hidhërimë,  
Ndonjëherë duhen bërë korrigjime,  
Që të mos bëhen shkatërrime.*

*Hidhërimi ynë është hidhërimi i nënave,  
Gëzimi ynë është gëzimi i nënave,  
Atyre u zgjatet jeta prej dëshirave,  
Prandaj të gjithë tu bëjnë nder nënave.*

*Vajtja, ardhja te njëri tjetri të afron,  
Jeta e kaluar, kujtime të zgjon,  
Sjellja e mirë, fjala e ëmbël të zbukuron,  
Harmoninë, miqësinë ta ruajmë gjithmon.*

*Hallet e vështirësitë bëhen më të lehta,  
Kur gjëzimet sjellin kënaqësi të vërteta,  
Mirë është kështu të jetëjeta,  
Familjeve të tila u bëhen lëvdata.*



DËSHMORËVË TË KOMBIT

---

*Për çdo vit kur vjen 5 maji,  
Shqipëria qan dëshmorët me vaj,  
Kombi kujton trimëritë e tyre,  
Që për liri dhanë jetën e tyre.*

*Ata luftuan në çdo fshat,  
Në luftë trimat hodhën shtat,  
Luftuan në çdo krahinë e qytet,  
Gjakun që derdhët kurrë s'do harrohet.*

*Te kodra ju preheni,  
Dhe përherë ju shtoheni,  
Me heronj të rinj bashkoheni,  
Të gjithë për ju krenohemi.*

*Edhe sot, kur keqbërësi shkatërron,  
Qytetari i ndershëm e mbron,  
Dhëmb për dhëmb me të lufton,  
Gjakun për Shqipëri e dhuron.*

*Gjithmonë do nderohen luftëtarët e lirisë,  
Sepse ia kushtuan jetën Shqipërisë,  
Ata ranë në lulen e rinisë,  
Për ti dhënë dërmën robërisë.*

*Vitet ikin e ju mbeteni të gjallë,  
Emrat tuaja i gjen në çdo mëhallë,  
Të gjithë përmendeni në gojën e popullit,  
Bulevardi kryesor quhet “Dëshmoret e Kombit”.*



*FOTOGRAFIA*

*Një vajzë puntore dua,  
Me këngë e përshëndes,  
Pushimeve është me mua,  
Transheve në mëngjes.*

*Fotografia e saj,  
Në xhep më buzëqesh,  
Djersitur në stërvitje,  
Ajo forca më ndez.*

## *NDRYSHIME*

---

*Kur isha i vogël,  
Jeta ishte ndryshe,  
Kishte pak bukë,  
E s'ngopesha me thërrime.*

*Luftha kishte gllabëruar,  
Shtëpi, ura, njerëz  
Jeta u bë më e vështirë,  
Çdo gjë ishte nxirë.*

*Por jeta filloi të gjallërohet,  
Mbas luftës fitimtare,  
Atdheu filloi të rizgjohet,  
Mëngjezeve të mbushura me vrulle.*

*Jeta filloi të ushqej arrat,  
Dhe në faqet e fëmijëve,  
Shëndeti hidhte valle,  
Familjet kishin më pak halle.*

## GJURMË JETE

---

*Kaluan edhe disa vite,  
Djersa ime, djersa jote,  
U kthyen në oxhaqe e petale,  
E në më shumë hidroçentrale.*

*Nëntor 1976*



### *QYTETI I LINDJES*

---

*Çdo njeri ka rrënjët e veta,  
Në halle e gëzime i kujton,  
Në njerëzit e fisit ato i gjeta,  
As një njeri si harron.*

*Gjirokastra, qyteti i lindjes,  
Qyteti i gjyshëve dhe i stërgjyshëve,  
Qytet i punës e i mëndjes,  
Qytet i luleve dhe i gurëve.*

*Ngjitem kalasë përpjetë,  
Ulem e pushoj mbi xhaketë,  
Shikoj malet gjer te retë,  
Seç më vijnë mentimet e shkretë.*

*Rrugëve të Gjirokastrës,  
Eci rënduar në mendime,  
Kujtoj vitet e dyzet e katrës,  
Me shumë vuajtje e mendime.*

## GJURMË JETE

---

*Mendoj e hidhem në vite,  
Rritur me thërrime buke,  
Me zjarr shkarpe,  
E dritë hëne.*

*Nën kujtimet e rënda,  
Shoh nga lart qytetin brenda,  
Shtëpi guri e të argjenda,  
Më të bukura e të rënda.*

*Gjirokastra rrëzë malit,  
Lumi Drino kalon te zalli,  
Shpesh për ty më merr malli,  
Të kujtoj kur rri te mangalli.*

1967



ÇAJUP ÇOCKËS

*Kur në shkurt u bë stërvitje,  
Dhe furtunat sillnin shi,  
Ti Çajup u veshe ushtar,  
E u ndave me njerëzi.*

*Ti u ndave me fëmijët,  
I puthe ata si për herë të fundit,  
Nëna, gruaja të përcollën,  
Por në mendje i mbete ti.*

*U ngroh koha! Thanë,  
U bë mirë,  
Ndërsa në mal, djali, burri,  
Kishte ngrirë.*

*Kur në pranverë lulet çelën,  
Malet akoma të kishin në gjë,  
Seç u shkri bora e ty të gjetën,  
Me çantën e pushkën përbri.*

## GJURMË JETE

---

*Kur në pranverë jeshiloi bari,  
Nisen zogjtë të shtegëtojnë,  
Mbi ty dielli ndriste si ari,  
Kockat ti mblodhën siç është zakon.*

*Ne, të afërmit e shokët,  
Kujtime ruajmë për ty,  
Ty i dashur nuk të pamë,  
Kur të mbuluan petale.*

*Shkurt, 1984*



## *SHOKËT*

---

*Dalëngadalë vitet kalonin e ne u rritëm,  
Klasat e shkollës një nga një i ngjitëm,  
Objektivat që kishim ne i arritëm,  
Më në fund në maturë ne mbrritëm.*

*Shumë lëndë kishim e ne mësonim,  
Stërvitje të rënda bënim por ne i kalonim,  
Si partizanët në luftë vështirësitë i duronim,  
Së afërmëti në repartet e ushtrisë do të shkonim.*


*Dhe ja tani kujtojmë se sa shumë u bashkuam,  
Për ta dashur shokun aty mësuam,  
Këngët e kohës së bashku i kënduam,  
Dhe vitet e shkollës kurrë si harruam.*

*Orët e lira pas mësimit i donim,  
Në jetën kolektive shumë lojra bënim,  
Me hap rrjeshtor shumë këngë këndonim,  
Por ndonjë të shtunë edhe vallzonim.*

## GJURMË JETE

---

*Mblidhem i dhe kujtojmë moshën e fëminisë,  
Mblidhem i dhe kujtojmë jetën e rinisë,  
Mblidhem i dhe kujtojmë si erdhën ditët e lirisë,  
Sa shumë punuam për të mirën e Shqipërisë.*



*NË MBRËMJE*

---

*Ja disku i hënës përsëri u ngrit,  
Në kopshtin me lule ti më prit,  
Syri i vashës seç u ndrit,  
Kur pa djalin sy petrit.*

*Nga larg degjoheshin zëra njerëzish,  
Tek tuk te lehura qenesh,  
Por ato thurnin ëndërra të rrinjsh,  
Jeta e re atyre u buzëqesh.*

*MOTIV*

*Sa shumë njerëz shkruajnë poezi,  
Kjo vjen ngaqë jetën e shohin me sy,  
Frymëzohen nga arritjet,  
Dhe nga ndryshimet në vitet.*

*Kur ke dëshirë të shkruash poezi,  
Fut në to vargje me djersë,  
Fut në to vargje me dashuri,  
Fut në to vargje me shpresë.*

## *RINISË*

*Rinia është koha më e bukur e jetës,  
Rinia e ëndërrave dhe e shpresës,  
Rinia e punës dhe jo e përtesës,  
Rinia e të ardhmes e më të mirës.*

*Kush i vogël e i qortuar, i madh do jetë i lavdëruar,  
Por mos harro, prindërit duhen respektuar,  
Të mëdhenjtë dhe mësuesit duhen nderuar,  
Se fjala e tyre nuk ka të çmuar.*

VALLËZIM

---

*Çdo ditë pushkën e ftohtë e mbanim mbi supe,  
Trupin e ngrohnim me hapat në marshim,  
Ngado që shkuam,  
U mblodhëm të lodhur në vallzim.*

*Ishin ditët e fundit të vtit,  
Festimi Vítit të Ri u bë tradit,  
Shumë lodra i hodhëm bredhit,  
Çdo gjë e bukur u përgatit.*

*Dhe vajzat u kthyen nga puna,  
Në të ftohtin e mbrëmjes, kristal,  
Veshën fustanet më të bukura,  
Në mbrëmje do shkonin të kërcenin me ushtar.*

*Ja, salla e vallzimit gumëzhinte,  
Dhe valcit, orkestra ç'ja thoshte,  
Dhe ne thurnim ëndërra rinore,  
Dhe hëna nga jashtë na përgjonte.*

1956

*LULET*

---

*Lulet të zbukurojnë jetën,  
Syri kënaqet ku i shikon,  
Por më shumë i shijoj kur jam vetëm,  
Prandaj dal shpesh në ballkon.*

*Edhe në dhomë kemi shumë lule,  
Ato nuk janë si të ballkonit,  
Ato janë artificiale,  
Prandaj nuk merr erë sipas zakonit.*

*Tufat janë të gjitha të bukura,  
Në to gjen vjollca e karafila,  
Të gjitha bëhen si të hazdisura,  
Kur në to shton edhe trëndafila.*

*Nuk do lë pa përmendur,  
Edhe lulet nëpër varre,  
Ato janë vendosur aq dendur,  
Sa edhe era si fshin fare.*

## GJURMË JETE

---

*Luleve i kushtojnë vëmendje,  
Shumë shkrimtar, piktor e poet,  
Ato të shplodhin mendjen,  
Të qetësojnë e shpirtin ta bëjnë det.*

*Pa le kur shkojmë nëpër lëndina,  
Nga lulet nuk largohesh dot,  
Një përrua i vogël mes tyre gurgullon,  
Nga rrezet e diellit të dalin lot.*



## VJESHTA

*Iku vera, erdhi vjeshta.  
Bëni gati rrobat e leshta.  
Edhe verën shumë e deshta.  
Por vjeshta është më e freskëta.*

*Vjeshta është me bereqet.  
Por dimri nuk vonohet.  
Pra mblidhni ato shpejt,  
Se dita zë shkurtohet.*

*U nxi rrushi, u nxi moti.  
Mjerë ai që s'qe i zoti,  
se prodhmi ikën kot së kотi,  
Nga ngrica e i ftohti.*

*Sa është vjeshtë dil në natyrë.  
Shëtit mbi gjethë i vetmuar.  
Shplodhu dhe hiq mënxyrë.  
Jepi jetë shpirtit të trazuar.*



*FISET*

---

*Shumë shekuj më parë,  
Adami dhe Eva shtuan racën njerëzore,  
U bënë shumë të parë,  
I ranë botës mbarë.*

*Çdo shtet në botë,  
Ka fise plot,  
Kjo s'është fjalë e kot,  
Janë aq sa si numëron dot.*

*Edhe në Shqipëri,  
Janë më mizëri,  
Nga Tropoja në Çamëri,  
Të gjithë jetojnë në vëllezëri.*

*Në histori po të shikosh,  
Shumë fise do të dëgjosh,  
Dhe sa do të rrosh,  
Të tjerë do të dëgjosh.*

*Në fisin Kastrioti,  
Skëndeberu ishte më i zoti.  
Skënderbeu patrioti,  
Kështu u quajt që moti.*

*Në disa fise,  
Mbiemri u ka hije,  
Se në to kanë yje,  
I lartësojnë prej lavdie.*

*Të dëgjuara janë fiset Topulli,  
Edhe Kalivopollı nga Dropulli,  
Frashëri, Kadare e Agolli,  
Të gjithë të nderuar nga populli.*

*Ka edhe të tjerë,  
Që u bëhet nderë,  
Daija, Deda e Mula,  
Roshi, Ndrenika e Trebicka.*

*Por mos harro,  
Se është edhe fisi Hajro,  
I lashtë sa princesha Argjiro,  
I shpërndarë kudo.*

## GJURMË JETE

---

*Punoni, punoni,  
Asnjëherë mos përtoni,  
Që veten ta nderoni,  
E fisin ta lartësoni.*

1983



*NË DITË-LINDJEN*

---

*Erdhën sot miq e shokë.  
Ditëlindjen time më urojnë  
Të afërmit, njerëzit e shtëpisë,  
Të gjithë njerëzit e mi gëzojnë.*

*Me gruan kalova një jetë të tërë,  
Ti atëherë papritur hyre në ditët e mia,  
Me ty ndjeva dashurinë,  
E bukur ishte si vetë rinia.*

*Të parin urim ma dha gruaja,  
Me radhë, mbesat, djali, vajza, nusja,  
Por unë u befasova,  
Nga urimi i bukur që më dha nipçja.*

*Ashtu si dielli, natyrës i jep jetë  
Dhe dielli i jep ujit plotë dritë  
Ashtu u deshëm ne të gjithë në jetë  
Me fjalën e ëmbël e të mirë.*

*VAZO ME KARAFILA*

*Kam një vazo në ballkon  
Me trendafile kuqëron  
Nënq ato fort e donte  
Se ballkoni kundërmonte*

*Do ta ruaj e do ta punoj,  
Do ta vadis e plehëroj,  
Që karafila të lëshojë,  
Në çdo përvjetor asaj t'ia çoj.*

*GJURMA JETË*

---

*Njeriu në jetë ka shumë gjurma,  
Ato janë të ëmbëla e të hidhura,  
Hyjnë në jetë pa shumë zhurmë,  
Disa prej tyre janë më të hasdidura.*

*Lindja është gjurma e parë,  
Këtë ditë e feston gjihtë bota mbarë,  
E pa harruar mbetet edhe klasa e parë,  
Pa le kur bëhemë universitarë.*

*Shumë gjurma lë vendi i punës,  
Rrogën e parë që ia çuam nënës,  
Pushimet ia lëmë të shtunës,  
Këto janë vite që i vihen gunës.*

*E pa harruar mbetet dasma,  
Për ta zbuluar blehen basma,  
Pijet derdhen si çezma,  
Emri i nuses është “Esma”.*

## GJURMË JETE

---

*Ka edhe shumë gjurmë të tjerë,  
Që njeriu i kujton përherë,  
Shumë nga ato kanë vlerë,  
Dhe kujtohen në kohë të vështire.*

*Dhe pa kuptuar ikën jeta,  
Me të përposhta e të përpjeta,  
Të çdo njeri shumë gjurma gjeta,  
Në këtë libër ato i treta.*



*Robert Hajro*

---

### *TEK RRI NË BALLKON*

---

Shtëpia ose më mirë apartamenti i familjes sonë, ndodhet në një nga rrugët kryesore të Tiranës, që quhet Muhamet Gjollesha, afër Lanës.

Në ballkon, ndonëse është i vogël, dal si në mëngjes edhe në mbrëmje e sodis gjallérinë e kësaj rruge, sidomos gjatë verës. Kur dal në të, më pëlqen të shikoj vazot me lule që aq shumë i shërben Vera, gruaja ime, jo për mburje por bie në sy për llojshmërinë e luleve.

Dalë në ballkon dhe më pëlqen të shikoj si gdhin dita, më pëlqen se si qyteti zgjohet, kush janë kalimtarët e parë.

Kur nata fillon t'ia lërë vendin ditës, del dielli nga ana e malit të Dajtit, qielli fillon të ndriçohet, kurse pikat e tjera të horizontit qëndrojnë akoma të errëta. Por kjo nuk zgjat shumë dhe qielli fillon e lartësohet dhe gjithë natyra zbardhon e yjet veniten sa nuk arrij ti shikoj më.

Ja një grup njerëzish rrinë përtej rrugës në trotuar me çanta të mëdha të vëna në tokë, poshtë pemës së gështenjës.

Ora 5:00 dhe kalon autobusi i parë me targa SR(Sarandës). Ndaloni para këmbëve të tyre. Fatorino ndihmon

në sistemimin e çantave,dhe të gjithë zënë vend në karriget bosh.Autobusi vazhdon rrugën, por jo me shumë pasagjerë.Pastaj, vijnë edhe autobuzë të tjera që vijnë nga stacioni i autobuzëve, që ndodhet pranë stadiumit “Dinamo”.

Sa mirë!- thashë me veten time,-tani nuk është problem udhëtimi, ka vende plotë. Para disa vitesh duhet të shkojë në agjensi disa ditë përpara për të siguruar biletat e udhëtimit për qytetin e largët.

Shikohen edhe arkat e para me fruta e zarzavate që sjellin tregtarët për tek tregu që ndodhet tek ura, brinjë Lanës.Ja ku shkojnë edhe fshatarët me furgona, me bidonat me qumësht e koshat me bimët e stinës.

Tregu dhe ambienti përreth është mjaft i papastër, ku dominon pluhuri, balta,dhe për strehë tregtarët kanë vënë qese plasmasi të lidhura në binarë peme, e mjete rrëthanore.

Flitet që si tregu ashtu edhe ato kioskë apo shtëpi,që janë ndërtuar në të dyja anët e Lanës, do të prishen..

Por edhe gjatë rrugës tonë vihen re që janë bërë ndërtime e shtesa jashtë pallateve edhe ato do të prishen. Parashikohen projekte ndërtimi si gjatë rrugës Muhamet Gjollesha,po ashtu dhe pastrimi i Lanës. Presim që do të bëhet diçka e bukur!

Dielli nxjerr kokën mbi malin e Dajtit. Fillon të ndriçojë aq bukur ballkoni, pallatet, parqet, gjithë natyrën. Makina e spërkatjes me ujë kalon gjatë gjithë rrugës duke spërkatur asfaltin e pluhurosur, ndonëse më përpara e kanë fshirë punëtorët

## GJURMË JETE

---

e bashkisë. Rrezja e diellit mië bie në sy, është e fortë, e zjarrtë dhe më bën që ti shmangem përballimit me të.

Tani rruga gumëzhin nga makinat, furgonat, autobuzë e njerëz tē shumtë që kalojnë trotuarëve. Policët edhe pse ka semaforë tek kryqëzimi i rrugëve, janë të detyruar të ndjekin rradhët e shumta të makinave. Ata i shikon atje në diell, por edhe në shi. Detyra, punë e vështirë. Te kalimtarët shikoj njerëz tē veshur mirë, por sidomos vajza tē reja tē veshura me gusto, plaka e pleq me qese nëpër duar që kthehen nga pazari. Rruga gumëzhin nga makinat e shumta, nga kalimtarët që shkojnë e vijnë për tē bërë punët e ditës. Kështu kalojnë ditët e netët. Dalin e perëndoijnë; Dielli e Hëna duke ia lënë rradhën njëra-tjetrës.

Kjo ështëjeta e përditshme në rrugën tonë!

10 Qershor 2002



*Robert Hajro*

---

### *NJË SHËRBIM I PAHARRUAR (viti 1965)*

---

Kisha afro 10 vjet që dilja çdo verë në punime për përgatitjen e hartave topografike në shk. 1:25000. Për përgatitjen e hartave ishim të përkushtuar të gjithë në mënyrë që të paraqisnim sa më mirë malet, luginat, rrugët, qendrat e banimit, me një fjalë të gjithë portretin e atdheut. Të gjithë oficerët topograf kalonin me rrallë në magazinë që të merrnin materialet e ekspeditës si: çadra fjejte, enë, ushqime, instrumentet topogeodezik si dhe dokumentet me urdhër të ministrit për punimet. Kur vinte vera më vinte keq që po ikja nga familja, nga Tirana, kur shumë moshatarë të mi e kalonin kohën pranë familjeve dhe mbasditeve shëtisnin në bulevardin e madh të Tiranës. Por kishte edhe të mirat e veta, se po e shkelnim Shqipërinë me këmbë, pëllëmbë për pëllëmbë si dhe me dietat që merrnim përmisonim sadopak gjendjen ekonomike të familjeve tona.

Kur mbërrita në Peshkopi më bëri përshtypje qyteti i vogël por i pastër e i sistemuar me rrugë të drejta. Ndërtesa më e bukur në atë kohë ishte Hotel Turizmi. U sistemuam në Brigadën e qytetit dhe aty rregulluam jetën tonë të përditshme.

Filluam pa humbur kohë punimet. Mua më kishte rënë për detyrë në perëndim të qytetit të përgatitja fotografitë ajrore për deshifrim dhe përgatitjen e pikave plano-naltimetrike. Kjo punë plotësohesh dita-ditës, sipas planit të miratuar nga komanda e repartit.

Një ditë u nisa për punime gjeodezike në majën e Runjës. Bënte vapë. Ngjitesha faqes së malit nëpër rrugë këmbësore, herë nëpër hijet e pemëve e herë nëpër rrezet e diellit. Kjo rrugë ngjitej me zik-zake duke shkelur nëpër gurë e bar. Ushtarët, që na jepeshin nga repartet në këto raste, i kishim të zgjedhur me fizik të fortë që fërballonin ngarkesën e rëndë të instrumenteve. Ata mbanin mbi shpinë instrumentin, trekëmbëshin, çadrën e diellit, latën si dhe çantën me ushqimet e drekës. Ata ishin të sjellshëm dhe të gatshëm për çdo lloj pune. Këtë sjellje ne nuk rrnim pa ja shpërblyer me lejet që i jepnim për shtëpi, 5-7 ditë sipas rastit kur kryenim punime në zyrë.

Ecnim dhe nuk bënim muhabet por dëgjoheshin vetëm kërcitja e këpucëve, rrëshqitja e ndonjë guri që rrrokullisej derisa ngelte te ndonjë shkurre apo trung peme. Sa më tepër ngjiteshe aq më shumë ndjehesh lodhja dhe djersa që na mbushte ballin, trupin. Kështu që na duhesh të ndalonim e të shplodheshim herë pas here.

Nga faqja e malit shikoje poshtë pejsazhe të bukura, fshatra me grupe shtëpish të mbledhura si: Muhuri, Brezhdan, Kastrioti

## GJURMË JETE

---

etj si dhe luginën e thellë, ku mes saj shikoje një ndriçim gjarpërues, i hollë, i gjatë që humbiste mbrapa maleve. Ky ishte lumi Drini i zi. Ishte e kotë të shikoje bukuri të reja sepse po këto pamje shikoje, pyjet e dendura tek lugina e Selishtës e male për rrith.

-Të shohim kur të ngjitemi në majë- u thashë unë,- ulemi aty rrëzë asaj peme. Të gjithë ramë dakort.

Tek pushonim dëgjonim lëvizjet e gjetheve, shikonim se si milingonat njiteshin trungut të pemës, ngjyrën jeshile të klorofilit të gjethave, barit si dhe rrezet e diellit që binin mbi to. Herë pas here na ledhatonte fytyrën, trupin një fllad i freskët që sikur na hiqte atë lodhje të ngjitjes malore.

Hë, u shplodhët, - u thashë ushtarëve- me ujë si jemi, kemi?

Jo, na mbaroi, - u përgjigj njëri prej tyre.

Mirë- u thashë,- do bëjmë çdo bëjmë edhe pak dhe do të ngjitemi, dhe mbasë mbarojmë punë shpejt.

U ngritëm dhe vazhduam rrugën.

Mbasi ecëm edhe pak, u ndodhëm para një sheshi të vogël, ku rrëzë saj ndodhej një kasolle. Aty ishte stani. Qentë sa na ndjen filluan të lehnin dhe u sulën drejt nesh. Por i zoti i foli me zë të fort dhe ata e ndalën vrapin. Bela! Nganjëherë vihesh në siklet, kafshët e sidomos qentë janë besnik i të zotit edhe mund të kafshojnë po s'u mbrojte me shkop ose ndonjë dru. Ne ato i kishim me vehte, se siç i thonë një fjale të urtë “Mos hy në katund pa një hu në dorë, se të hanë qentë”, ”Kujto qenin e bëj gati shkopin”

Pasi ndaluam, u afrua i zoti i stanit. Pasi u prezantuam i kërkuam nëse kishte pak ujë për të pirë:

-Po pate edhe për t'na i mbushur këto pagure, mirë do bësh.

-Posi- tha bariu dhe u ngjit drejt kasolles.

Na solli paguret plot me ujë dhe një enë me dhallë dhe na gostiti të gjithëve me dhallë

-Rrini po të doni të hamë një kafshatë bukë me atë që na ndodhet.

-Jo,- i thashë- se kemi punë për të bërë. Faleminderit!

Dhe u ndamë duke vazhduar rrugën e përpjetë. Nuk vonuam dhe mbërritëm në majën e Runjës, me lartësi 2047m. Maja e malit vinte e rrumbullakët por e mprehtë dhe e zhveshur. Mbi majë qëndronte si lapidar piramida prej hekuri me katër këmbë rrëth të cilave ishin vendosur grumbuj gurësh. Aty kishin qenë një vit më parë shokët tanë gjeodet të cilët kishin ngritur në të gjithë Shqipërinë një rrjet të tërë trekëndshash, në kulmet e të cilave kishin vendosur pika trigonometrike,dhe pasi kishin bërë matjet e këndeve horizontale të trekëndshave dhe këndeve vertikale midis tyre, kishin arritur të llogarisnin me saktësi koordinatat dhe lartësinë e tyre nga niveli i detit Adriatik. Këto pika ishin pika ku do të mbështeteshim për përgatitjen e hartave. Ulëm instrumentët nga krahët dhe i vendosëm afér piramidës. Pashë orën e llogarita që na u desh afro tre orë të ngiteshim në majë nga ura e Muhurit. Unë menjëherë fillova nga puna duke ngritur instrumentët mbi centrin e piramidës dhe fillova të kërkoj pikat e tjera gjeodezike,sipas projektit.

## GJURMË JETE

---

-Juve,- u thashë ushtarëve,- uluni e shlodhuni. Pini ndopak ujë.

Njëri prej ushtarëve u shkëput nga ne dhe shkoi më poshtë,për tu shtrirë në një vend me bar të thatë. Por pasi e hapi pak barin, pa në të borë të ngrirë.

-Ej, këtu paska akoma borë- thirri ai.

Çudi, poshtë në qytet e ultësira të tjera bora kishte shkrirë me kohë, këtu nëpër luginat e vogla afër majës gjeje akoma borë e fshehur poshtë barit!

Menjëherë ushtarët shkuan e mbushën paguret me borë dhe i ruajtëm ato derisa u shkrinë. Këtu në majë të malit e zgjidhëm problemin e ujit. Por këtu më doli një problem. Pasi bëra matjet me instrument në pikat gjeodezike përreth, kur erdhi koha të përcaktoja pikën plano-naltimetrike afro 300 m larg majës së Runjës, na mungonte lata me të cilën matnim largesitë me instrument. Atë e kishim harruar në repart. Si t’ia bënim? Kishim bërë gjithë këtë rrugë, do të na shkonte mundimi kot të zbrisnim e të vinim prap të nesërmen. Do ishte lodhje e tepërt. Nuk kisha eksperiencë të madhe. Vrava mendjen dhe e zgjidha.

-Shko rrëzë pyllit atje tej,- i thashë një ushtari,-dhe zgjidh një shkop 2-3 metër të drejt e të hollë, të jetë sa më i gjatë.

Pas pak ushtari erdhi dhe vërtet kishte sjell atë që kërkova. Shtriva mbi të shiritin 2m dhe e lidhëm atë pas shkopit. Filluam prapë nga puna dhe i orientova ushtarët drejt vijës që do matja. Këtë largësi e mat pjesë pjesë me latën e improvizuar duke

nxjerrë përfundimisht largësinë e kërkuar. Pasi nxorra të dhëna të tjera shpova në fotografinë ajrore qoshen e livadhit që ndodhej në vendin e kërkuar. Tani u qetësova pasi edhe kjo punë mbaroi.

U ngjitëm përsëri por tani të qetë të mërrnim rrugën e kthimit. Ishte ora 6:00 e mbasdites. Qëndruam për të pushuar edhe pak në malin e Runjës. Tani po shikoja edhe njëherë natyrën përreth.

Dielli kishte marrë rrugën e perëndimit por akoma kishte fuqi ngrohëse dhe objektet kishin lëshuar një hije të gjatë nga ana e lindjes. Kurse qyteti i Peshkopisë dallohej më mirë tani sepse dielli ndriçonte fasadat e pallateve si dhe malin madhështor të Korrabit që ngrihej mbi qytet. Më tutje nga ana e veriut shtriheshin kodra të veshura me pemë të dëndura. E dija që midis tyre ndodheshin liqenet e Lurës, aq të dëgjuara për bukuritë e tyre. Por gjë e bukur ishte prroi i Setës, që zbriste në një pjerrësi të madhe ujin e bollshëm e të freskët të këtyre liqeneve e pastaj bashkohej me ujin e Drinit, në afërsi të Zall Dardhës.

Shihja në qiell që fluturonin zogj dhe pasi bënë një koreografi për kënaqësinë e ditës që po kalonin, pastaj morën drejtimin drejt çerdheve të tyre pasi po afronte nata.

Ngre sytë përpjetë i ngazëlluer nga freskia e mbrëmjeze nga suksesi i punës së kësaj dite, dhe i them shokëve të mi ushtarë, që duhet të çohemi e të nisemi se kishim shumë rrugë për të bërë.

## GJURMË JETE

---

-Dakort, si të doni ju shoku kapiten. Ne jemi gati.

Pasi u ngarkuam përsëri për marshim, u nisëm. Ktheva edhe një herë kokën, e pashë atë majë ku zor të më vinte radha të shkoja prap në atë vend të bukur. Dhe vërtet s'më ra rasti të shkojë prap ndonjëherë. Për tu çmallur ngadonjëherë i shikoj ato vende, ku kam punuar në vende të ndryshme të Shqipërisë, nëpërmjet hartave topografike që i kemi bërë me duart tona.

---

*Shënim: Ato vite ne krijuam hartat e para Shqipëtare në shkallë të mëdha. Ndërsa tanë lind nevoja që ato harta të azhornohen ose më mirë të freskohen me ndryshimet që pëson terreni.*



*Robert Hajro*

---

### ORTEKU

---

Dimër, 6 shkurt. Natë. Kohë e keqe. Ftohtë. Bie borë e imët si miell. Në terren malor koha e keqe rëndon shumë. Çdo vit studentët e armëve të ndryshme, shkonin në Feken për stërvitje dimërore, në kushtet e motit dimëror e terrenit të vështirë malor në lartësinë mbi 1100 m. mbi nivelin e detit.

Ditën e ngjarjes kisha shërbimin e oficerit të rojes. I ftohti i ditës dhe lodhja nga stërvitja, bënë që studentët t'i zinte gjumi shpejt. Gjatë gjithë natës, bora e re që binte pa pushim zuri vend mbi borën e vjetër që kishte ngrirë. Ajo u bë shkak që të nesërmen të ndodhnin orteqet. Studentët, pasi hëngrën mëngjesin, morën pajimet dhe u rreshtuan për t'u nisur në vendet e stërvitjes.

Qielli ishte me ngjyrë gri dhe frynte erë e fortë. Njëmbëdhjetë toga, me në krye pedagogun e fiskulturës, Mark Micin, filluan t'i ngjiten majës së Meçekut, me kuotë 1827 m. Pasi bënë pjesën më të madhe të rrugës, papritur, ne lartësinë rrëth 1400 m, filloi të rrëshqasë bora, e cila morri me vehte pjesën qëndrore të kolonës së studentëve. Pjesa anësore e saj, vëreu se si u zhdukën shumica e studentëve, të përzierë me llavën

e ortekut të dëborës. Menjëherë ata u varën poshtë që të shpëtonin shokët, aty ku ndaloj orteku, mbi rrugën automobilistike, në pemët e shumta që ndodheshin aty.

Rreth orës 10:30, shoh dy studentë, që zbrisnin me vrap si drerët e shkathët në pjerësinë e madhe të kodrës mbi kamp, duke ardhur drejt meje. Në ato momente, zemra më ndjeu diçka të keqe. Ata ishin lajmëtarët që më dhanë lajmin: "Ra orteku, shumë shokë janë nën borë, duan ndihmë". Po aty u dëgjuan edhe të shtëna armësh, nga vendi i ortekut.

Në kamp, në çast u dha alarmi. Boria u dëgjua në gjithë faqen e malit ku bëhej stërvitja. Vetëtimthi u mblohdhën qindra vetë, me në krye komandën e shkollës, Rustem Peçin dhe Burhan Llukaçin, si dhe trupën pedagogjike e komanduese.

Heroizmi masiv i studentëve e oficerëvë, kundër egërsisë së natyrës, bëri që të shpëtonin nga kthetrat e vdekjes, shumë nga shokët. Fatkeqësish midis tyre pati dy të vdekur. Në përpjekje e sipër për të nxjerrë të gjithë nga bora, erdhi orteku i dytë. Ai bëri më shumë dëme, sepse zuri nën vete, edhe ata që kishin ardhur, për të shpëtuar shokët. Si rezultat gjithsej mbetën të vdekur njëmbëdhjetë shokë, u paralizuan dy, dhe u plagosën nëntëdhjetë e tre të tjerë. Midis tyre pedagog Petrit Murzakun, e shpëtoi shoku i tij Myzafer Kambo, në mënyrë krejt të rastësishme, duke i parë mbi borë, vetëm gishtat e duarve.

Pasditen e 6 shkurtit, lajmi, siç ndodh zakonisht në këto raste, u përhap në gjithë Tiranën. Nga spitali ushtarak, u ngritën

dy helikopter me ekipin mjekësor për të dhënë ndihmën e parë dhe për të marrë të vdekurit dhe ata që ishin plagosur rëndë. Në sheshin e kampingut u shtruan banderolat me beze të kuqe në formë “T” për të orientuar helikopterët se ku duhet të uleshin. Koha u egërsua edhe më shumë. Bora vazhdonte të binte e të bënte ftohtë. Por mbi të gjitha era e fortë nuk lejonte që helikopterët të uleshin në kamping. Pilotët e panë më të arsyeshme të uleshin te “Qafa e Patateve” rrëth 2 km larg kampingut. Kështu u desh që shokët e tyre student ti merrnin me krevatët e tyre në vend të barrelave, e të përshkonin rrugën nëpër borë, të zbrisnin në prroin e Marrashit e pastaj të ngjiteshin në faqen malore ku prisnin helikopterët. Në të ngrysur u plotësua numri që mund të mbante helikopterët dhe u nisën të dy helikopterët te sheshi i Spitalit Ushtarak. Koha e keqe nuk i la të bënин rrugën dytë, kështu që ekipi mjekësor ndenjën aty duke i shërbyer te koka të gjithë studentëve të plagosur. Të nesërmen erdhën forca të tjera, makinat e batalionit të transportit, qen kufiri për kërkimin e kufomave, që akoma nuk ishin nxjerrë, e të tjerë.

Mua mu ngarkua detyra të rilevoj zonën e ortekut: pjesa ku ai filloj, ishte shumë e pjerrët e pa drurë, kurse aty ku përfundoj, ishte një luginë e ëmbël dhe me pemë, të cilat e rritën fatkeqësinë pasi aty lava e borës kishte përplasur trupat me forcë, duke i dëmtuar për vdekje.

Të rënët ishin të gjithë të rinj. Shumica vinin nga shkolla ushtarake “Skëndërbej”. Vitet kalojnë dhe kujtimi i tyre ka mbetur i gjallë në mëndjet tonë. Për të kujtar të rënët, këto ditë u organizuar një ceremoni në Akademinë ushtarake “Skënderbej” nën kujdesin e komandantit të saj, kolonel Skraparliu, kryetarit të shoqatës “Skënderbej” Mikado Shakohoxhës, dhe Qani Duros, nga shoqata “Për të rënët e Kombit”, në prani të shumë familjeve të të rënëve, dhe qindra studentëve, të rreshtuar në sheshin qëndror të Akademisë. Të afërmit dhe familjarët e të rënëve, u shprehën se “për ta përjetojmë njëherazi dhembje dhe krenari...”. Xhaxhai i Dushanit, Kadri shametaj, midis të tjerash tha: “Studentët dhe pedagogët thurrnin ëndërrat e së ardhmes...në jetën kolektive ushtarake. Dashuria dhe respekti reciprok...i çuan ata drejt sakrifikimit të jetës, për të shpëtuar shokët. Ju, me këtë ceremoni tregoni se nuk i latë dhe nuk do ti lini në harresë, shokët tuaj, që ishin lavdia e shkollës suaj”.

Komandanti i Akademisë, kolonel Flamur Skraparliu ndër të tjera tha: “6 shkurti, nuk është si ditët e tjera, ajo mbart në vetvehte një histori, që të rënëve i ju dha përjetësi”. Burhan Llukaçime këtë rast tha: “Mund të them se ata vunë gurë themeli me gjak gatuar, në traditën e lavdishme të kësaj shkolle. Si të tillë ata zenë vend nderi, në kollonën e mermertë të “Dëshmorëve të Kombit”. Për këtë foli edhe Qani Duro duke u shprehur: “Ata në emër të jetës sfiduan orteqet, dhe në krah të njëri tjetrit, dhanë provën madhore që i shenjtëroi për jetë “Dëshmorë të Atdheut”.

## GJURMË JETE

---

Në emër të kryetarit të bashkisë të Tiranës, Albert Brojkës të rënëve të Fekinit ju shpérndanë fletët “Dëshmorë të Atdheut të cilat i morën familjarët dhe të afërmith e tyre. Ata ishin Dushan Shameti, Çlirim Pulaj, Nikollaq Bero (që të tre ish oficerë), si dhe studentët: Aleko Gjoni, Besnik Shehu, Bilbi Pasha, Bujar Ago, Ilir Gramatiko, Nexhip Copa, Pëllumb Rrapaj Qemal Lika... me këtë novacion: “Në luftë të ashpër me forca e natyrës, dhanë jetën e tyre të re, për të shpëtuar nga vdekja shokët e irrezikuar në ngjarjen e 6 shkurtit, të 1981”. Dy pre tyre që mbetën invalidë ishin: Luan Meça nga Peshkopia dhe Përparim Veliu nga Saranda.

Ata mbetën aty rrëzë malit me Gropa, por të pavdekshën pasi çdo 6 shkurt, shokët, oficerët, studentët e Akademis Ushtarake, mbledhen e kujtojnë me nderim këtë ish Skenderbegas, ish kuadro, për devotshmërinë e tyre në rritjen cilësore të stërvitjeve.

Në ambjentet e akademisë, për t'i nderuar këta, në mes një lulishteje, është ngritur një lapidar, ku janë gdhendur emra e 11 dëshmorëve të 6 shkurtit të 1981.

Nderim e respekt shokëve tanë të paharuar!

Dëshmitar okular i ngjarjes: Ish kuadër i shkollës

Ing. Robert Hajro

*Botuar në gazetën “SKËNDERBEGASI*

*Mars 2001*



*Robert Hajro*

---

*FJALA E MËNÇUR VLEN MË SHUMË  
SE ARI*

---

-Gjysh, o gjysh – i tha Altini gjyshit- të lutem më shpjego pse: “Fjala e mençur vlen më shumë se ari”. Nesër e kam për detyrë në klasë.

-Mirë – i tha gjyshi. Merr fletoren e shkruaj.

-Po gjysh, por më parë më thuaj: Pse blehet fjala me flori?!

Gjyshi u mendua pak. Ai dinte shumë fjalë të urta ose siç i thonë ndryshe fjalë të mençura por donte ta bindte nipin dhe filloi t’ia shpjegonte:

-Jo, fjalët e mençura nuk blehen me flori por ato kanë vlerë të madhe për jetën. Ato dëgjohen në emisionet e radios dhe televizionit, në bisedat familjare, në punë, mësohen nga leximi librave, gazetave. Por ka edhe libra të posaçëm që shiten nëpër librari, me shumë fjalë të mençura, – tha gjyshi.

Këto fjalë e zbukurojnë gjuhën në të folur e në të shkruar, por në të njëjtën kohë, japid edhe këshilla për ecurinë normale të jetës, pa grindje, vrasje, por duke punuar e mësuar sa më shumë.

-Ja për shembull: “Shkolla e bën njeriun njeri” ose “Pësimi bëhet mësim”. Pra çdo njeri duhet të mësojë nga çdo ngjarje e keqe apo e mirë që ndodh në jetën tonë.

-Ose një fjalë tjeter: “Fëmija që s’dëgjon t’ëmën del në rrugë e thyen këmbën”.

-Po jo, more gjysh. Sa herë kam dalur unë e asgjë s’më ka gjetur.

-Nuk është fjala për një herë e dy herë, - itha gjyshi – por fëmija duhet të mari leje e të dëgjojë këshillën e prindërve.

Dhe pastaj gjyshi vazhdoi:

-Është edhe kjo fjala e mënçur: “Prindi të rrit, shkolla të ndrit”.

-Po gjyshi e vërtetë. Unë po mësoj shumë gjera në shkollë, por edhe ju më keni ndihmuar.

-Altin, shikon në televizor, se pothuajse çdo ditë vriten njerëz?

-Po dhe më vjen keq. Ja dje e dha televizori se u vra një fëmijë më pistoletën e të atit, - ju përgjigj Altini.

-Po pra, “Arma nuk është lodër dhe s’është për të lojtur” e babai nuk kishte parasysh fjalën e mençur “Që të mos kesh dhimbje mos i jep armën fëmijëve”

Pas pak vazhdoi gjyshi:

-Ja një fjalë tjeter për punën “Ku ka bletë, ka edhe mjaltë” ose “Dora me baltë, buza me mjaltë”.

-Po gjyshi e di që bleta shkon lule më lule e mbledhin mjalt por xha Beni punon gjithë ditën në arë dhe buzët nuk i ka më mjaltë.

-Jo more Altin, por me punë njeriu siguron të gjitha të mirat “Puna është nëna e gëzimit”. Ja po të them një fjalë tjeter për sjelljen,- vazhdoi gjyshi,- “Nga gabime të vogla kalohet në ves të mëdha”, si dhe “Do të rrrosh me nder mbi dhe? Me të lig mos u përziej”. Pra me sjelljet që bën tregon veten çdo njeri.

-Jo,- tha Altini,- unë nuk shoqërohem me Çimin sepse a është trazavaç. Por me të tjerët unë luaj dhe ndihmojmë njëri tjetrin në mësimë.

-Shumë mirë!- tha gjyshi.- Të bëhesh i mënçur e të dallosi kush është e mirë e kush e keqe.

-Ka shumë e shumë fjalë të tjera të mençura. Por për sot mjaft. Pra fjalët e mençura vlejnë më shumë se ari sepse të mësojnë shumë gjëra për jetën që është gjëja më e shtrenjtë nuk këtë botë.

-Po gjysh të kuptova.

-Altini i kënaqur filloi të shkruajë fjalët e mënçura në fletoren e detyrave.

*Robert Hajro*

---

**PËRMBAJTJA:**

Tirana në shekullin e XXI .....	3
Gërmadhë.....	6
Refugjatit.....	7
Ish Skënderbegasve.....	9
Vendlindjes.....	11
Atdheut.....	13
Letër.....	15
Lufta.....	16
Vëllezërve.....	18
Ata të dy.....	19
Fjala e ëmbël.....	20
Në një ditë prilli.....	21
Topografit.....	22
Prindërve.....	24
Mbesave.....	26
Nipit.....	27
Pranverës.....	28
Tek burimi.....	29
Në televizor.....	30
Familja.....	31

Dëshmorëve të kombit.....	33
Fotografia.....	35
Ndryshime.....	36
Qyteti i lindjes.....	38
Çajup Çoçkës.....	40
Shokët.....	42
Në mbrëmje.....	44
Motiv.....	45
Rjinisë.....	46
Vallëzim.....	47
Lulet.....	48
Vjeshta.....	50
Fiset.....	51
Në ditëlindjen.....	54
Vazo me karafila.....	55
Gjurma jete.....	56
Tek rri në ballkon.....	59
Një shërbim i paharruar.....	63
Orteku.....	71
Fjala e urtë vlen më shumë se ari.....	77
Përbajtja.....	81